



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
OEVERIA - VLADA - GOVERNMENT



MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT - ODELJENJE ZA INSPEKCIJE - DEPARTMENT OF INSPECTION

Referencë: **IPK/29032022/DI**

Datë: **29.03.2022**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektim në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit, Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024) dhe Planin Vjetor të Inspektiveve të Rregullta, Departamenti i Inspektiveve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Administrimi i patentë shoferëve të konfiskuar
Referenca	- 02/2022
Data e inicimit	- 21.02.2022
Data e raportimit	- 29.03.2022
Arsyet e inicimit	- Bazuar në Planin Vjetor të Inspektiveve të Rregullta (2022)
Objekti	- Vlerësimi i administrimit të patentë shofereve të konfiskuar nga njësitë policore
Metodologjia	- Intervistë (takime) me 17 drejtues dhe bartës funksionesh; (a) Shefi i Sektorit për Planifikim Permanent (1); (b) Zyrtarë të administrimit të patentë shoferëve të konfiskuar (8); (c) Zyrtarë të SIPK-ut në stacione policore të kategorisë A (8). - Këqyrje dhe verifikim: 389 dosje të kundërvajtjeve në trafik; - Marrje dokumentesh për nevoja të raportimit.
Subjekti	- Stacionet policore të kategorisë A (Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë Jugu, Mitrovicë Veriu, Pejë, Prishtinë Jugu dhe Prizren Alfa), Divizioni i Sigurisë Publike - Departamenti i Operacioneve.
Afatet	- Fillimi - 03.03.2022; - Përfundimi - 04.03.2022; - Periudha e mbulimit - viti 2021 dhe dy muajt e parë të vitit 2022.
Kriteret vlerësuese (standardet)	- Ligji nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor; - Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 15/2017 për Procedurën e Kundërvajtjes në Trafikun Rrugor; - Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 07/2018 për mbajtjen dhe qasjen në evidencën e të dhënave për aksidentet në trafik, për shoferët dhe për mjetet.

Ekipi realizues	- Kushtrim Jonuzi, udhëheqës i ekipit të inspektimit, - Kadri Keçmezi, inspektor, - Mirsad Puqurica, inspektor, - Servet Tasholli, inspektor, - Shqiponjë Sopi, inspektor, - Xhavit Fetahaj, inspektor
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Rastet dhe Cilësi
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-ve
Datë	- 29.03.2022



<p>Gjetjet kryesore:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Inspektorët kanë kontrolluar 335 dosje të kundërvajtjeve me konfiskim dokumentesh, ku në 330 prej tyre janë gjetur të arkivuara patentë shoferet. Në shtatë (7) nga tetë (8) stacione të inspektuara është hasur praktikë e atillë që me rastin e shqiptimit të kundërvajtjeve që përcillen me masa mbrojtëse dhe pikë negative, që në të gjitha rastet janë konfiskuar patentë shoferët, të cilat gjatë inspektimit janë gjetur të arkivuar. Kurse, nga ana e një stacioni tjetër policor, patentë shoferët janë konfiskuar nga njësitë policore në momentin e shqiptimit të kundërvajtjeve, por që janë kthyer më pas, pasi që janë paguar gjrobat. IPK-ja edhe më parë ka raportuar mbi mënyrën dhe praktikimin e marrjes (konfiskimit) të patentë shoferëve për kundërvajtjet që përcillen me pikë negative dhe masa mbrojtëse. 2. IPK-ja ka analizuar edhe më parë qasjen e tillë, me çka edhe e ka nxitur Policinë për të qartësuar sidomos situatat e marrjes- konfiskimit të patentë shoferëve. Me ligj janë paraparë situatat kur zyrtari policor ka të drejtë të marrë përkohësisht patentë shofer¹. Policia vazhdon të konfiskoj patentë shoferë pa zbatuar në disa raste (situata), rregullat mbi përjashtimet lidhur me marrjen apo konfiskimin e tyre në momentin kur kryhet kundërvajtja. Edhe vërtetimi që parashihet të lëshohet me rastin e konfiskimit të patentë shoferëve, nuk përmban në vete dispozita që mbështesin konfiskimin e patentë shoferëve përtej situatave (rasteve) të parapara në nenin 248 të Ligjit për Rregullat në Trafikun Rrugor (Pezullimi i dokumentacionit për drejtim të mjetit). Këtë situatë e ka bërë edhe më konfuze Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 15/2017² në versionin e tanishëm, dispozitat e të cilit vlerësohet se nuk janë konform frymës së legjislacionit në fuqi. 3. Praktika e tanishme e marrjes së patentë shoferit (përveç rasteve të cekura në ligj) është e gabuar dhe për këtë duhet që Policia të njoftojë pjesëtarët e saj për rastet (situatat) kur ata duhet të konfiskojnë patentë shoferët. Lidhur me këtë, IPK është njoftuar se Policia është në proces të rishikimit të Udhëzimit në fjalë, me çka dhe pritet të qartësohet çështja e marrjes së patentë shoferëve. Çmohen angazhimet për harmonizimin e rregullativës ligjore për sigurinë në trafik rrugor dhe inkurajohet autoriteti policor që në fokus të trajtimit të Udhëzimit përkatës, ta ketë harmonizimin e tij me dispozitat e legjislacionit aktual. Konfiskimi i patentë shoferëve (përveç situatave të parapara me ligj), para se fletëparaqitjet për kundërvajtjet të marrin formën e prerë, nuk kanë bazë ligjore dhe njëkohësisht mund të cenojnë të drejtat e palëve në procedurë. Përderisa nuk ka qasje ndryshe nga praktikat e deritanishme të marrjes së patentë shoferëve, IPK qëndron pas rekomandimit të dhënë në Raportin e inspektimit (datë 19.11.2019)³. 4. Me gjithë faktin se stacionet mbajnë evidencë fizike dhe elektronike për kundërvajtjet, IPK-ja ka hasur se regjistrat fizik nuk janë unik në asnjërin prej tyre. Regjistrat fizik ndryshojnë varësisht nga stacioni në stacion në formatin si mbahen ato, por edhe se të njëjtit nuk përmbajnë të dhënat mbi kundërvajtjen siç e parasheh Udhëzimi Administrativ nr. 15/2017, që përcakton se çfarë duhet përmbajtur evidenca për kundërvajtjet e trafikut rrugor⁴. Sa i përket evidencës elektronike, stacionet policore shfrytëzojnë Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK), i cili ka të dhëna të mjaftueshme për kundërvajtjet nga fusha e sigurisë rrugore.
---------------------------------	--

¹ Neni 247 dhe 248 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor.

² Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 15/2017 për procedurën e kundërvajtjes në trafikun rrugor.

³ Raporti i inspektimit nr. 03/2019 - Menaxhimi i patrullimeve dhe sigurisë në rrugë.

⁴ Udhëzimi Administrativ nr. 15/2017, neni 22.

	<p>5. IPK është interesuar të njihet me funksionimin e SIPK-ut dhe procedurën e evidentimit lidhur me futjen e të dhënave në të. Sipas procedurave të parapara ligjore, futja e të dhënave për kundërvajtësin, për të cilin përveç gjobës janë shqiptuar pikë negative, apo masa mbrojtëse, duhet proceduar evidentimi në bazën e të dhënave brenda afatit të përcaktuar ligjor. Për evidentimin e pikëve negative dhe të masave mbrojtëse në evidencën e shoferit, këto masa evidentohen: (a) nëse brenda tetë (8) ditëve nga data e shqiptimit të kundërvajtjes, nuk ushtrohet kundërshtim; dhe (b) me vendim të plotfuqishëm të organeve kompetente⁵. Nga fletëparaqitjet e inspektuara, të cilat janë proceduar në Sistem, zyrtarët përgjegjës të SIPK i kanë futur të dhënat pa i respektuar afatet e përcaktuara ligjore.</p> <p>6. IPK-ja vlerëson se ka një mos harmonizim të Udhëzimit me Procedurën Standarde të Operimit - Sistemet Informative të Policisë së Kosovës, i cili përcakton që zyrtarët që regjistrojnë të dhënat në stacione/nënstacione dhe drejtoritë, janë të obliguar që brenda orarit të ndërrimit tetë (8) orësh, t'i evidentojnë rastet dhe të dhënat shtesë, duke përfshirë kallëzimet penale, kundërvajtjet në trafik rrugor (tiketat), letër rreshtimet, urdhër arrestet, urdhëresat, etj.⁶ Verifikimet e evidencave të masave mbrojtëse dhe pikëve negative në SIPK pasqyrojnë se ato janë realizuar pa kaluar ende periudha kohore, pas të cilës kundërvajtjet marrin formën e prerë. Evidentimi i pikëve negative dhe masave mbrojtëse para se kundërvajtjet të marrin formën e prerë, mund të krijojnë pasoja juridike për palët.</p> <p>7. Verifikimi në SIPK i të dhënave mbi kundërvajtjet ka pasqyruar edhe disa vërejtje tjera. Janë vërejtur mangësi në evidentimin e shënimeve të plota mbi kundërvajtjet, d.m.th, janë hasur raste kur në SIPK nuk janë përfshirë të gjitha shënimet e nevojshme të fletëparaqitjeve⁷. Po ashtu, në ditën kur është realizuar inspektimi, janë hasur edhe dy (2) raste kur kundërvajtjet nuk janë evidentuar edhe pse ato ishin shqiptuar dy (2) muaj më parë⁸. Sipas zyrtarit të SIPK-ut, vonesat e tilla vijnë si rezultat i ngarkesës në punë të personelit policor lidhur me evidentimin në përgjithësi të rasteve.</p> <p>8. Ligji nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid - 19 në territorin e Republikës së Kosovës në nenin 24, paragrafi 1 dhe 5 ka përcaktuar gjokat lidhur me mosrespektimin e kufizimit të lëvizjes dhe mosmbajtje të maskës. Gjatë kontrollit të patentë shofereve të konfiskuar, janë hasur gjashtë (6) raste kur Policia ka shqiptuar gjoka ndaj shtetasve të huaj për shkelje të masave kundër Covid, ku veç shqiptimit të gjobave mbi bazën e Ligjit nr. 07/L-006, ka konfiskuar edhe patentë shoferë me qëllim të sigurimit të pagesës së gjobave⁹. Edhe pse Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugor përcakton se në cilat raste konfiskohen patentë shoferët, IPK-ja vlerëson se aplikimi i konfiskimit të dokumenteve nga Policia me qëllim të sigurimit të ekzekutimit të pagesës të gjobave që lidhen me mosrespektimin e dispozitave të Ligjit nr. 07/L-006, është praktikë e gabuar dhe e njëjta nuk ka mbështetje ligjore.</p>
--	--

⁵ Neni 17 i Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 15/2017 për procedurën e kundërvajtjes në trafikun rrugor.

⁶ Procedura Standarde e Operimit - Sistemet Informative të Policisë së Kosovës (nr. referues DPPK-01/0852/21, datë 28.10.2021), kapitulli VI, paragrafi 2 (Trajtimi i informatave), pika 2.3.

⁷ Lidhur me kundërvajtjen SHQ5A0001770188R, Zyra e SIPK-ut në Mitrovicë Veriu nuk ka evidentuar në Sistem, masën mbrojtëse për tre (3) muaj. Po ashtu, lidhur me kundërvajtjen SHQ5A0001770155C, nuk ka evidentuar në Sistem, masën mbrojtëse për periudhën në kohëzgjatje prej tre (3) muaj dhe dy (2) pikët negative.

⁸ Më 04.03.2022 gjatë inspektimit në Stacionin Policor - Prishtinë Jugu, në SIPK nuk janë gjetur të evidentuara Fletëparaqitjet për kundërvajtje me nr. 0001949607Q dhe 00019011987.

⁹ Fletëparaqitjet nr.: 0001896289A, 00013544360, 00016818637, 0001613085P, 00011497056, 0001847866X.

<p>Vlerësimi i përgjithshëm</p>	<p>Bazuar në gjetjet e inspektimit, IPK-ja vlerëson se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✦ Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 15/2017 vazhdon të sjellë paqartësi mbi situatat dhe rastet se kur duhet konfiskuar patentë shoferët, dhe si rezultat i kësaj paraqiten praktika të ndryshme të konfiskimit; ✦ Meqë Udhëzimi në disa raste krijon konfuzion në zbatimin praktik në fushën e marrjes - konfiskimit të patentë shoferëve, duhet të rishikohet që të jetë në harmoni me Ligjin për Rregullat në Trafikun Rrugor; ✦ Stacionet policore mbajnë evidenca për kundërvajtjet (elektronike dhe fizike), por se këto të fundit i kanë të ndryshme varësisht iniciativave të tyre; ✦ Vërehet një mosharmoni ndërmjet Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 15/2017 e Procedurës Standarde të Operimit mbi Sistemet Informative të Policisë së Kosovës rreth periudhës së evidentimit të kundërvajtjeve në SIPK; ✦ Janë hasur lëshime nga zyrtarë të SIPK-ut në evidentimin me kohë të fletëparaqitjeve, por edhe në evidentimin jo të plotë të të dhënave mbi kundërvajtjet (mungesë e masave mbrojtëse dhe pikëve negative); ✦ Janë hasur disa raste kur pa mbështetje ligjore, janë konfiskuar patentë shoferë, në zbatim të Ligjit nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës.
<p>Rekomandimet</p>	<p>Bazuar në gjetjet e inspektimit, IPK-ja vlerëson se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✦ IPK-ja i rekomandon Zyrës Ligjore të kuadër të Policisë së Kosovës që në vazhden e rishikimit të legjislacionit dytësor, të eliminojë të gjitha paqartësitë rreth marrjes - konfiskimit të patentë shoferëve dhe kohës së evidentimit të rasteve në SIPK, duke siguruar që të jetë në harmoni me legjislacionin primar; ✦ IPK-ja i rekomandon stacioneve policore që me rastin e evidentimit të të dhënave në SIPK, të sigurohen gjithnjë se kanë evidentuar të dhënat e plota lidhur me kundërvajtjet; ✦ IPK-ja u rekomandon stacioneve policore që në drejtim të zbatimit të Ligjit nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, të ndalojnë praktikatat aktuale për konfiskimin e patentë shoferëve, në përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë parashihet me legjislacionin në fuqi nga fusha e trafikut.

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	IPK-ja i rekomandon Zyrës Ligjore të kuadër të Policisë së Kosovës që në vazhden e rishikimit të legjislacionit dytësor, të eliminoj të gjitha paqartësitë rreth marrjes - konfiskimit të patentë shoferëve dhe kohës së evidentimit të rasteve në SIPK, duke siguruar që të jetë në harmoni me legjislacionin primar.	-I-	Policia e Kosovës ka konstatuar se ka paqartësi andaj lidhur me këtë çështje ka propozuar që udhëzimi të futet në plan legjislativ të MPB-së për aktet nënligjore për vitin 2020, 2021 dhe 2022 për ndryshim - plotësim e Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 15/2017 për Procedurën e Kundërvajtjes në Trafikun Rrugor dhe i cili për këtë vit po shpresojmë që do të miratohet pasi që i ka kryer të gjitha procedurat e parapara për hartim të aktit nënligjor (konsultimin paraprak dhe tani është në procedurat e konsultimit publik ku priten edhe komentet). Për informim, Zyrtar Përgjegjës për plotësim-ndryshim të këtij udhëzimi është Kryesuesi i Komisionit për Vendosje dhe sipas tij është adresuar edhe kjo çështje në këtë udhëzim.	Është realizuar plotësisht
2.	IPK-ja i rekomandon stacioneve policore që me rastin e evidentimit të të dhënave në SIPK, të sigurohen gjithnjë se kanë evidentuar të dhënat e plota lidhur me kundërvajtjet.	-I-	Do të ushtrohet kontroll më i madh që rastet të evidentohen me të dhënat e plota lidhur me kundërvajtjet si dhe do të udhëzohen përmes një qarkore të gjitha njësitë policore për zbatim.	Në vazhdimësi
3.	IPK-ja u rekomandon stacioneve policore që në drejtim të zbatimit të Ligjit nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, të ndalojnë praktikën aktuale për konfiskimin e patentë shoferëve, në përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë parashihet me legjislacionin në fuqi nga fusha e trafikut.	-I-	Do kërkohet që në rastet e shkeljes së trafikut të veprohet sipas ligjit të trafikut dhe nuk do të konfiskohen patentë shoferët për kundërvajtje që nuk ndërlidhen me çështje të trafikut!	Në vazhdimësi